EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8421
E premte, 30 tetor 2026
Çmimi 0. 50 €

FSK-ja pranon 12 kamionë ushtarakë

FAQE 3

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RASTI TRAGJIK I ARLINDA ZEKAJT, SUSPENDOHEN KRYEPROKURORJA E PEJËS, PROKURORJA DHE 11 ZYRTARË POLICORË

FAQE 5

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka suspenduar kryeprokuroren e Prokurorisë Themelore në Pejë, Lumturije Vuçetaj, dhe prokuroren Arlinda Nallbani Gacaferri, për rastin e vrasjes së Arlinda Zekajt nga i dyshuari, kunati i saj. Ky vendim është marrë pasi kryeprokurori i Shtetit, Zejnullah Gashi, kishte rekomanduar suspendimin e tyre dhe kishte iniciuar procedurë disiplinore. Po ashtu, janë suspenduar 11 zyrtarë policorë. Ndërkaq, Kuvendi i Kosovës ka themeluar të enjten me 90 vota për Komisionin Hetimor Parlamentar për veprimet dhe mosveprimet e institucioneve lidhur me vrasjen e Arlinda Zekajt si dhe për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe grave në familje

OPINION

UÇK-ja NA BASHKOI SËRISH DHE E VURI SHTETIN NË VEPRIM

F. 3

Shkruan: Hajdin ABAZI

AKTUALE

ZELENSKY THOTË SE UKRAINA, RUSIA DHE SHBA-ja DO TË ZHVILLOJNË BISEDIME NË NËNTOR

F. 2

KGJK-ja DHE IRZ-ja ORGANIZOJNË PUNËTORI PËR FORCIMIN E MEKANIZMAVE TË VETËQEVERISJES DHE MBIKËQYRJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

F. 6

EKONOMI

‘STRATEGIC GROUP’ DHE ‘OCEAN B HOLDING’ NGA KATARI NISIN INICIATIVËN INVESTUESE PREJ DY MILIARDË DOLLARËSH PËR KOSOVËN DHE SHQIPËRINË

F. 8

SPORT

PËRBALLJE INTERESANTE NË XHIRON E 12-të NË SUPERLIGËN E KOSOVËS

F. 11

MIRATOHEN NDRYSHIMET NË BUXHETIN 2026, REFUZOHEN TË GJITHA REKOMANDIMET E OPOZITËS

F. 7

PAKETA E FINANCIMIT E MBËSHTETUR NGA BE-ja DO TË OFROJË MBËSHTETJE PËR AMVISËRITË, NVM-të DHE BIZNESET E UDHËHEQURA NGA GRATË

F. 7

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

ZELENSKY THOTË SE UKRAINA, RUSIA DHE SHBA-ja DO TË ZHVILLOJNË BISEDIME NË NËNTOR

KIEV, 29 TETOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se bisedimet në nivel teknik, ku do të marrin pjesë Ukraina, Rusia dhe Shtetet e Bashkuara, me synimin për t'i dhënë fund luftës, do të zhvillohen në Abu Dabi nga 6 deri më 10 nëntor. Duke folur në një konferencë për medie në Hagë më 28 tetor, Zelensky tha se mundësia e një takimi me presidentin rus Vladimir Putin mbetet e pasigurt. "Nuk e di se kur do të kemi një takim me Rusinë në nivel udhëheqësish", tha ai. "Për momentin, pavarësisht respektit që kemi për vende të ndryshme, kjo varet nga pala ruse, sepse ata nuk e kanë mbështetur kurrë më parë këtë ide".

Deklarata e presidentit ukrainas ishte përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj komenteve të presidentit amerikan Donald Trump, i cili u tha gazetarëve më herët gjatë së njëjtës ditë se një takim mes Zelenskyt dhe homologut të tij rus, Vladimir Putin, do të organizohej "shumë shpejt".

Trumpi nuk saktësoi ndonjë datë apo vend për takimin e mundshëm, por shtoi se "mund të arrihet shumë përparim në këtë drejtim".

Samiti i G20-s, i cili mbahet në Florida në dhjetor, paraqet mundësi për një takim të drejtpërdrejtë mes udhëheqësve ukrainas dhe rusë. Megjithatë, Putini ende nuk i është përgjigjur ftesës së Shteteve të Bashkuara, ndërsa ai dhe Zelensky kanë qëndrime dukshëm të ndryshme sa i përket mundësisë së një takimi të tillë.

Putini është përpjekur ta vërë në dyshim legjitimitetin e Zelenskyt dhe ka deklaruar vazhdimisht se presidentët mund të takohen vetëm pasi të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse për paqe. Megjithatë, ai ka sugjeruar gjithashtu se mund të takohet me Zelenskyn në Moskë. Kremlini e di se mundësia e mbajtjes së një takimi në kryeqytetin e vendit që po sulmon Ukrainën është e papranueshme për Kievin. Zelensky ka shprehur gatishmërinë për t'u takuar me Putinin në një vend të tretë dhe ka thënë se çështjet thelbësore, si ajo e territoreve, mund të zgjidhen vetëm në nivelin e udhëheqësve.

Deklaratat e presidentit amerikan vijnë vetëm një ditë pasi presidenti finlandez, Alexander Stubb, dhe kryeministri norvegjez, Jonas Gahr Store, zhvilluan një bisedë telefonike 90-minutëshe me Putinin ku diskutuan për pushtimin rus të Ukrainës. Udhëheqësit nordikë zhvilluan bisedë telefonike edhe me Zelenskyn.

Në një njoftim për medie Stubb theksoi se "diskutimi ishte i hapur dhe përmbajtjesor". "Ne jemi vende fqinje me Rusinë. Përfundimi i kësaj lufte do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë tonë dhe në atë të Evropës në tërësi. Për t'i dhënë fund luftës nevojiten diskutime të drejtpërdrejta", shtoi presidenti finlandez.

Kryeministri norvegjez Jonas Gahr Store e kishte pritur në Oslo më 20 tetor Zelenskyn, të dërguarin e posaçëm të Trumpit, Steve Witkoff, si dhe disa zyrtarë evropianë, në përpjekje për t'u siguruar që vendet evropiane të kenë rol në negociatat për t'i dhënë fund pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Rusia.

Zelensky, i cili ka shprehur disa herë shpresën se udhëheqësit dhe vendet evropiane do të përfshihen më shumë në bisedime për paqe, tha gjatë vizitës zyrtare në Holandë se "ne presim që Evropa të ketë rol të madh, por edhe nga ana e Evropës na duhet më shumë qartësi se kush e përfaqëson atë". Megjithatë, ai shtoi se "nëse Amerika thotë se kësaj radhe do

të kemi vetëm bisedime trepalëshe, ne nuk do ta prishim këtë format".

Intensifikimi i aktiviteteve diplomatike perëndimore vjen pasi Vladimir Putini propozoi më herët gjatë tetorit një samit trepalësh me Shtetet e Bashkuara dhe udhëheqësin kinez Xi Jinping, kah fundi i vitit, me synimin për t'i dhënë fund luftës. Vizita e Zelenskyt në Holandë solli edhe premtime të reja për mbështetje ndaj Ukrainës nga kryeministri holandez, Rob Jetten, i cili njoftoi se vendi i tij do të ofrojë 500 milionë euro ndihmë ushtarake gjatë këtij dimri, përfshirë dronë dhe pajisje të tjera.

Qeveria holandeze premtoi gjithashtu 1.2 miliard euro mbështetje joushtarake gjatë tri vjetëve të ardhshme, përfshirë fonde për rindërtimin dhe riparimet urgjente të infrastrukturës energjetike të Ukrainës.

ARMËPUSHIMI NË OLESHKI HYN NË DITËN E TRETË, SHPRESAT PËR NDIHMË HUMANITARE NDESHEN ME FRIKËN NGA DËBIMET

OLESHKI, 29 TETOR - Një armëpushim i brishtë në zonën përreth Oleshkit, që ndodhet nën pushtimin rus, hyri në ditën e tretë më 29 tetor, duke ngjallur shpresë për mijëra civilë që përballen me mungesa të mëdha dhe rrugë të rrezikshme për t'u larguar, mes frikës se Rusia mund ta shfrytëzojë këtë pauzë për t'i transferuar me forcë banorët në Rusi ose në Krimenë e pushtuar.

Armëpushimi i lokalizuar, i ndërmjetësuar me përfshirjen e zonjës së parë të Shteteve të Bashkuara, Melania Trump, hyri në fuqi më 27 tetor dhe është planifikuar të zgjasë deri më 1 nëntor. Zyrtarë ukrainas dhe amerikanë i thanë Radios Evropa e Lirë (REL) se gjatë dy ditëve të para nuk është raportuar për shkelje. Megjithatë, mungesa e shkeljeve të raportuara ka bërë pak për t'i ulur shqetësimet lidhur me pasojat e operacionit. Zyrtarët ukrainas dhe përfaqësuesit e organizatave humanitare thonë se suksesi i tij do të varet nga fakti nëse banorët do të marrin ndihmë, do të mund të evakuohen në mënyrë të sigurt dhe do të jenë të lirë ta zgjedhin destinacionin e tyre.

Armëpushimi vjen në një kohë kur Uashingtoni dhe Moska po përgatiten për një takim të mundshëm diplomatik, teksa ligjvënësit amerikanë po debatojnë për mbështetjen e mëtejshme për Ukrainën.

Christine Lagarde largohet nga drejtimi i Bankës Qendrore Evropiane 9 muaj para përfundimit të mandatit

BRUKSEL, 29 TETOR - Christine Lagarde, presidente e Bankës Qendrore Evropiane (BQE), do të largohet nga detyra më 7 shkurt 2027, rreth nëntë muaj para përfundimit të mandatit të saj, i cili ishte parashikuar të zgjaste deri në fund të tetorit të vitit të ardhshëm.

Lajmi u bë me dije nga Banka Qendrore Evropiane. Sipas raportimeve, Këshilli Drejtues i institucionit e falënderoi Lagarde për punën e saj dhe e përshëndeti me duartrokitje të gjata gjatë takimit ku po shqyrtohej politika monetare dhe niveli i normave të interesit në eurozonë.

Largimi i parakohshëm i Lagarde ka nxitur spekulimet për angazhimin e saj të ardhshëm profesional. Ajo është përmendur si një kandidate e mundshme për ta marrë drejtimin e Forumit Ekonomik Botëror (WEF), organizata që organizon takimin e përvitshëm të liderëve politikë dhe ekonomikë në Davos të Zvicrës. Themeluesi i forumit, Klaus Schwab, u largua nga drejtimi vitin e kaluar, pas akuzave për shkelje financiare dhe etike, të cilat ai i ka mohuar. Megjithatë, deri më tani nuk është konfirmuar zyrtarisht se cili do të jetë angazhimi i ardhshëm i Lagardes.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kurti: Anëtarësimi në NATO mbetet prioritet strategjik i Kosovës

PRISHTINË, 29 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në Zyrën e Kryeministrit një delegacion prej 11 anëtarësh nga nëntë shtete të ndryshme, të Komisionit për Politikë të Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

Në "Facebook", Kurti ka bërë me dije se në takim është diskutuar për bashkëpunimin dhe rrugën përpara, me fokus në përparimin demokratik, zhvillimin ekonomik dhe situatën e sigurisë në Kosovë dhe rajon.

Ai ka theksuar se anëtarësimi në NATO mbetet prioritet strategjik për Republikën e Kosovës, duke e cilësuar atë të rëndësishëm për paqen e qëndrueshme dhe sigurinë afatgjatë në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë. Sipas Kurtit, gjatë takimit është diskutuar edhe për ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe aftësimin profesional të ushtarakëve, në përputhje me politikat dhe standardet e Aleancës së Atlantikut të Veriut.

FSK-ja PRANON 12 KAMIONË USHTARAKË

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 TETOR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka pranuar 12 kamionë ushtarakë UNIMOG - Mercedes-Benz 5T, 4x4, të blerë për nevojat e saj. Lajmin e ka dhënë ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, i cili ka njoftuar se dorëzimi i automjeteve është bërë në prani të kryeministrit Albin Kurti, komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ambasadorit gjerman në Kosovë, Rainer Rudolph, si dhe përfaqësuesit të Daimler Truck Defence dhe Mercedes-Benz Special Trucks, Daniel Zittel. Sipas Maqedoncit, Gjermania po e mbështet FSK-në jo vetëm përmes blerjeve, por edhe me donacione.

Në vitin 2024 Kosova kishte pranuar pesë kamionë Rheinmetall KX 8x8 donacion nga Gjermania, ndërkaq gjatë vitit 2027 pritet të pranohen edhe dy kamionë Rheinmetall KX 8x8 dhe katër kamionë zjarrfikës UNIMOG - Mercedes-Benz, gjithashtu si donacion nga shteti gjerman.

Ministri bëri me dije se për vitin 2027 janë planifikuar të arrijnë edhe dhjetëra kamionë të tjerë të blerë për nevojat e FSK-së.

Me 12 kamionët UNIMOG dhe tetë kamionët Rheinmetall që kanë arritur gjatë kësaj jave, numri i automjeteve të pranuara deri më tani nga këto dy kategori ka arritur në 35. Sipas Maqedoncit, kamionët e rinj do t'i rritin kapacitetet transportuese dhe logjistike të FSK-së, duke mundësuar transportimin e personelit, pajisjeve dhe materialeve, si dhe furnizimin e njësive në terrene të vështira dhe në kushte të ndryshme operacionale. Ai theksoi se investimet në pajisje, infrastrukturë dhe kapacitete njerëzore do të vazhdojnë, me synimin për të ndërtuar një forcë profesionale, moderne dhe të ndërveprueshme me partnerët ndërkombëtarë, në shërbim të sigurisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se sot 12 kamionë ushtarakë Unimog 5T, 4x4, të tipit Mercedes Benz, iu shtuan flotës prej 15 kamionëve Rheinmetall. Ai ka thënë se ditë më parë kanë arritur edhe 8 kamionë të tjerë KX 8×8 të blerë nga Rheinmetall. "Me këto prurje të reja, numri i kamionëve të këtyre dy kategorive arrin në 35 automjete. Dhjetëra kamionë të tjerë Unimog dhe Rheinmetall janë blerë dhe do të vijnë në vitin 2027. Kamionët Unimog 5T janë të projektuar për të ofruar lëvizshmëri në terrene të vështira, përfshirë rrugët e paasfaltuara dhe zonat malore, kurse kamionët Rheinmetall me konfigurim 8×8 shtojnë kapacitetet transportuese të FSK-së dhe kontribuojnë në forcimin e mbështetjes logjistike", ka deklaruar Kurti.

Ai ka shtuar se një forcë moderne nuk ndërtohet vetëm përmes armatimit dhe pajisjeve luftarake, por edhe përmes kapaciteteve që i mundësojnë asaj të lëvizë, të furnizohet dhe të veprojë në mënyrë efikase. "Këto investime janë pjesë e angazhimit tonë për t'i forcuar kapacitetet mbrojtëse të Republikës së Kosovës, në përputhje me standardet e NATO-s dhe me synimin për të garantuar sigurinë e vendit dhe të gjithë qytetarëve tanë. Të premten e kaluar u betuan 515 rekrutë të rinj, në fillim të kësaj jave filluan trajnimin edhe 209 rekrutë të tjerë, ndërsa këtë javë po e mbyllim me pranimin e 12 kamionëve", ka thënë Kurti.

Shiroka-Pula takohet me komandantin suprem të NATO-s në Evropë, në fokus siguria në Kosovë

PRISHTINË, 29 TETOR - Presidentja e Kosovës, Justina Shiroka-Pula, ka pritur të enjten në takim komandantin suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Evropë (SACEUR), gjeneralin Alexus G. Grynkewich. Sipas njoftimit të Presidencës, gjatë takimit është diskutuar për situatën e sigurisë në Kosovë dhe rajon, rolin e NATO-s në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, si dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Aleancës.

Presidentja Shiroka-Pula ka shprehur mirënjohjen e Kosovës për kontributin e NATO-s dhe të misionit të KFOR-it në garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në vend. Ajo ka theksuar se prania e KFOR-it vazhdon të jetë e rëndësishme për sigurinë e të gjithë qytetarëve dhe ruajtjen e stabilitetit në Kosovë.

Gjatë takimit presidentja ka ritheksuar përkushtimin e Kosovës për forcimin e partneritetit me NATO-n dhe avancimin e bashkëpunimit me aleatët. Ajo ka nënvizuar se anëtarësimi në NATO mbetet një nga objektivat strategjike të Republikës së Kosovës.

Shiroka-Pula ka theksuar gjithashtu se Kosova mbetet e përkushtuar ndaj paqes, stabilitetit rajonal dhe bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO-n dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë.

RASTI TRAGJIK I ARLINDA ZEKAJT, SUSPENDOHEN KRYEPROKURORJA E PEJËS, PROKURORJA DHE 11 ZYRTARË POLICORË

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka suspenduar kryeprokuroren e Prokurorisë Themelore në Pejë, Lumturije Vuçetaj, dhe prokuroren Arlinda Nallbani Gacaferri, për rastin e vrasjes së Arlinda Zekajt nga i dyshuari, kunati i saj. Ky vendim vjen pasi kryeprokurori i Shtetit, Zejnullah Gashi, kishte rekomanduar suspendimin e tyre dhe kishte iniciuar procedurë disiplinore. Po ashtu, janë suspenduar 11 zyrtarë policorë. Ndërkaq, Kuvendi i Kosovës ka themeluar të enjten me 90 vota për Komisionin Hetimor Parlamentar për veprimet dhe mosveprimet e institucioneve lidhur me vrasjen e Arlinda Zekajt si dhe për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe grave në familje

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 TETOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), nën udhëheqjen e kryesuesit, Arian Gashi, mbajti të enjten një takim të jashtëzakonshëm, në të cilin shqyrtoi kërkesën e kryeprokurorit të Shtetit, Zejnulla Gashi, për fillimin e procedurës disiplinore ndaj kryeprokurores së Prokurorisë Themelore në Pejë, Lumturije Vuçetaj, dhe prokurores së rastit, njëherësh koordinatore për rastet e dhunës në familje, Arlinda Nallbani-Gacaferri.

Pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kompetent (kryeprokurorit të Shtetit), Këshilli Prokurorial i Kosovës vendosi të themelojë panel hetimor për trajtimin e rastit si dhe miratoi propozimin për suspendimin e të dy subjekteve të hetimit, ndaj të cilave kërkohet zhvillimi i procedurës disiplinore.

Vendimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës janë marrë në bazë të të gjeturave nga raporti me numër reference A. nr. 379/2026, e të paraqitura në kërkesën për fillim të hetimit disiplinor nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, që ndërlidhet me rastin e vrasjes së Arlinda Zekajt.

Gjithashtu, Këshilli Prokurorial mori vendim të caktojë për ushtruese të detyrës së kryeprokurorit në Prokurorinë Themelore në Pejë, Valbona Disha-Haxhosaj.

KPK-ja në këtë takim ka theksuar se mbetet i përkushtuar për ushtrimin e mandatit ligjor, garantimin e llogaridhënies dhe forcimin e integritetit të sistemit prokurorial, duke siguruar që të gjitha procedurat të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Po ashtu, Policia e Kosovës (PK), bazuar në Ligjin e Policisë së Kosovës, Udhëzimin Administrativ për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në Policinë e Kosovës si dhe rekomandimin e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), ka suspenduar 11 zyrtarë policorë lidhur me trajtimin e rastit të viktimës Arlinda Zekaj, të ndodhur në Vitomiricë të Pejës.

Ndaj zyrtarëve policorë është duke u zhvilluar një hetim paraprak nga Inspektorati Policor i Kosovës lidhur me veprimet apo mosveprimet e tyre për rastin në fjalë. Bazuar në rekomandimin e IPK-së, menaxhmenti i PK-së ka suspenduar: U. d. drejtorin rajonal në DRP-Pejë, shefin e Hetimeve Rajonale DRP-Pejë, komandantin e Stacionit Policor-Pejë, zv/komandantin e Stacionit Policor - Pejë, shefin e Sektorit të Hetimeve në Stacionin Policor-Pejë, U.d. shefin e Sektorit të Operativës në Stacionin Policor-Pejë, komandantin e Nënstacionit Vitomiricë dhe 4 (katër) hetues policorë të Stacionit Policor-Pejë.

Suspendimet janë bërë në interes të hetimeve të pavarura, llogaridhënies institucionale dhe përgjegjësive individuale, për trajtimin e rastit. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për ruajtjen e vlerave, integritetit dhe shërbimit në mënyrë të drejtë e të paanshme, si dhe do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha institucionet relevante.

Ndërkaq Kuvendi i Kosovës ka themeluar të enjten me 90 vota për Komisionin Hetimor Parlamentar për veprimet dhe mosveprimet e institucioneve lidhur me vrasjen e Arlinda Zekajt si dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe grave në familje.

Komisioni do t'i ketë 11 anëtarë dhe mandat maksimal prej gjashtë muajsh, njofton "Dukagjini".

Kryetar i tij do të jetë Burim Ramadani nga Aleanca, ndërsa zëvendëskryetar Adnan Rrustemi nga Lëvizja Vetëvendosje.

Anëtarë të komisionit nga Vetëvendosja do të jenë Armend Baloku, Arijeta Rexhepi, Osman Musliu dhe Adelinë Tërshani.

Nga PDK-ja do të jenë Besa Kabashi-Ramaj dhe Eman Rrahmani, ndërsa LDK-ja do të përfaqësohet nga Doarsa Kica-Xhelili.

Pjesë e komisionit do të jenë edhe Jovana Radosavljeviq dhe Emilija Rexhepi, në përfaqësim të komuniteteve.

Tri ditë para vrasjes Arlinda kishte kërkuar nga institucionet ndërhyrje

KURTI TAKON KOMANDANTIN SUPREM TË NATO-s NË EVROPË, FLET PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TË FSK-së

PRISHTINË, 29 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të enjten në takim komandantin Suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, njëherësh komandant i Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara, gjeneralin Alexus Grynkewich.

Në këtë takim Grynkewich ishte i shoqëruar nga komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Roberto Vergori, dhe nga e Ngarkuara me Punë në Ambasadën Amerikane në Kosovë, Anu Prattipati.

Sipas komunikatës së qeverisë, Kurti ka theksuar se Kosova po vazhdon investimet në mbrojtje, trajnimet dhe blerjet, me synim rritjen e profesionalizmit ushtarak dhe forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Ai ka bërë me dije se për katër vjet radhazi shpenzimet e Kosovës për mbrojtje kanë kaluar dy për qind të Bruto Produktit Vendor (BPV). "Për katër vjet me radhë shpenzimet tona për mbrojtje kalojnë 2 % të Bruto Produktit Vendor", ka thënë Kurti.

Kryeministri ka përmendur edhe zhvillimet e fundit në kuadër të FSK-së, duke bërë me dije se javën e kaluar janë betuar 515 ushtarë të rinj, ndërsa këtë javë 209 rekrutë kanë nisur stërvitjen bazë.

Kurti ka theksuar se Kosova është përpara planit dhjetëvjeçar për zhvillimin e kapaciteteve të saj mbrojtëse dhe synon ta përmbushë atë para vitit 2028. "Republika e Kosovës po vazhdon me trajnime e blerje, me synim rritjen profesionale ushtarake dhe ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Jemi përpara në planin dhjetëvjeçar dhe do ta përmbushim atë para vitit 2028", thuhet në komunikatë.

Gjatë takimit Kurti ka shprehur vlerësimin për rolin e NATO-s në çlirimin e Kosovës si dhe mirënjohjen për kontributin e KFOR-it në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në vend dhe rajon.

Ai ka theksuar se Republika e Kosovës e çmon rolin e NATO-s për çlirimin e vendit dhe është falënderuese ndaj KFOR-it për kontributin në ndërtimin e paqes së qëndrueshme dhe garantimin e stabilitetit afatgjatë në Kosovë dhe rajon.

Emil Maksuti emërohet zëvendësministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

Prishtinë, 29 tetor - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Emil Maksuti zëvendësministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kryeministri Kurti e uroi Maksutin për detyrën e re dhe i dëshiroi suksese në përmbushjen e përgjegjësive të reja.

urgjente për mbrojtjen e saj.

Qindra protestues marshuan në Prishtinë, kërkuan përgjegjësi institucionale për vrasjen e Arlinda Zekajt

Qindra protestues kanë marshuar të mërkurën në Prishtinë duke kërkuar përgjegjësi institucionale për vrasjen e Arlinda Zekajt, e cila kishte kërkuar në vazhdimësi nga institucionet mbrojtje nga dhuna në familje. Ajo dyshohet se u vra me sëpatë nga kunati i saj më 25 tetor, ndërsa bashkëshorti i saj po mbahej në ndalim për kanosje ndaj saj.

Vrasja e Zekajt, pas shtatë grave të tjera të vrara këtë vit, ka nxitur zemërim të madh në vend.

Arlinda Zekaj kishte kërkuar vazhdimisht ndihmë nga institucionet e drejtësisë dhe sigurisë duke raportuar dhunë në familje, përfshirë edhe disa orë para se të vritej.

Ndër kërkesat kryesore të protestuesve ishin përgjegjësia institucionale, përfshirë dorëheqjen e ministres së Drejtësisë, Donika Gërvalla, dhe të ministrit të Brendshëm, Xhelal Sveçla.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se në rastin e vrasjes së Zekajt qartazi shihet se kishte një zinxhir lëshimesh nga institucionet përgjegjëse.

Tetë gra janë vrarë këtë vit në Kosovë. Për vrasjen e tyre të dyshuar janë bashkëshortët apo anëtarë të tjerë të familjes.

Protestues të shumtë, po ashtu, mbajtën në duar pankarta që pasqyrojnë letrën që Arlinda Zekaj ua kishte dërguar organeve të drejtësisë dhe sigurisë, në të cilën thoshte se rasti i saj për dhunë në familje po neglizhohej. Po ashtu, ata kërkojnë ndjekje penale ndaj atyre që kanë neglizhuar rastin e Arlinda Zekajt.

Policia e arrestoi më 27 tetor të dyshuarin për vrasjen e Zekajt, ndërsa bashkëshorti i saj po mbahet në paraburgim për "kanosje", pasi ishte ndaluar nga policia para se të ndodhte vrasja.

Autoritetet janë kritikuar se nuk po bëjnë mjaftueshëm për ta parandaluar dhunën dhe vrasjen e grave.

UÇK-ja NA BASHKOI SËRISH DHE E VURI SHTETIN NË VEPRIM

Shkruan: Hajdin ABAZI

Më në fund, sikurse u njoftua dje, u mbajt takimi i parë i Grupit Punues.
Ky takim është tregues se shteti është vënë në veprim.
Dhe shkaku themelor është UÇK-ja.
Edhe 27 vite pasi e përmbylli misionin e vet të shenjtë të lirisjelljes dhe krenare u largua nga skena e veprimit faktik, UÇK-ja duket se ka një cilësi magjike efektet e së cilës jo vetëm nuk u shuan gjatë këtyre tri dekadave, por ato u shfaqën nga 16 shtatori me kaq fuqi kushtrimtare thuaja sa ç'e pati pas sakrificës madhore të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari e cila e zgjoi dhe e mobilizoi tërë kombin shqiptar.
UÇK-ja e zgjoi ndërgjegjen e politikanëve shqiptarë të të gjitha partive, sepse UÇK-ja ishte dhe është e të gjithëve që e donin dhe e duan lirinë, pa asnjë dallim e pa asnjë përjashtim.
Karakteri i saj gjithëkombëtar dhe me themel lirinë politike, kombëtare e njerëzore që nga lindja e saj ishin të kristalta dhe ju qëndroi besnike me gjithë sfidat dhe yshtjet nga regjimi pushtues i Serbisë për ta nxitur të devijonte.
Ndaj dhe lufta që bëri populli shqiptar që iu nënshtrua gjenocidit nga Serbia, pra lufta e tij çlirimtare e bërë përmes UÇK-së ishte ekskluzivisht mbrojtëse dhe absolutisht e drejtë, madje aq e drejtë sa kundër të njëjtit objektiv për ndaljen e gjenocidit dhe për mbrojtjen e qytetarëve civilë shqiptarë ndërhyri edhe Aleanca Veri-Atlantike - NATO.
Dhe çlirimi, liria, shtetbërja, pavarësia dhe demokracia, rendi e drejtësia janë vlerat e Kosovës që në themel e kanë kontributin, sakrificën, rezistencën dhe luftën çlirimtare të popullit shqiptar që e bëri UÇK-ja.
Megjithatë, duhet për të qenë korrekt, se pas ekzaltimit triumfal me arritjen e lirisë, u shënua një rënie e nivelit të ndërgjegjshmërisë për vlerat madhore të UÇK-së. Besohej se ato ishin të paprekshme, se UÇK-ja e kishte përmbyllur misionin e vet historik. Ashtu edhe ishte.
Porse kishte diçka që mund ta turbullonte kujtesën dhe pamjen madhështore të UÇK-së. Kjo edhe ndodhi: uzurpimet, abuzimet e përfitimet e ndryshme në emër të UÇK-së. Këto veprime e zbehën autoritetin dhe lavdinë e UÇK-së në sy të atyre që prekeshin. Kështu u krijua një antipati për secilin çlirimtarë thuaja pa dallim. Ndër të tjera, sepse nga vetë çlirimtarët nuk u denoncuan uzurpatorët dhe keqbërësit. Një pengesë mund të ketë qenë se drejtësia e UNMIK-ut në sy të çlirimtarëve nuk ishte e paanshme, po dukej sikur kishte një disponim kundër UÇK-së.
Aq më keq, një konflikt midis personaliteteve të njohura drejtuese të UÇK-së u shfaqën konflikte të ulëta, ku akuzat e ndërsjella ishin aq të rënda, sa u zbeh jo vetëm nga jashtë, po edhe nga ata që ishin me përgjegjësi të niveleve më të larta politike e komanduese.
Ky konflikt absurd bëri që të degjenerojë opinioni kundrejt UÇK-së. Madje, në disa raste, organizatat e dala nga lufta si ajo e veteranëve dhe e invalidëve, të konsideroheshin sikur kërkonin vetëm privilegje, ani se ishin tejet të diskriminuara.
Ndonëse e gabuar dhe e padrejtë, u krijua një klimë thuaja anti-UÇK. Kjo bëri që publikisht të shprehen mendime, opinione e narrativa që sinkronikisht e lenin më harresë lajtmotivin e UÇK-së - lirinë, po e vënin në plan të parë ndonjë gabim, i cili i vihej si eksponent vetë UÇK-ja.
Kjo klimë u bë e përshtatshme për ndërfutje të inteligjencave të ndryshme anti-Kosovë, të cilat vepronin she rekrutonin dëshmitarë të rrejshëm (AKI pari incizuar disa raste të tilla nga sigurimi serb dhe ato u patën publikuar).
Kështu u krijuan artificialisht, prej papjekurisë sonë e prej inteligjencave anti-Kosovë, parakushtet që të shfaqej raporti famëkeq i Dick Martit me akuza njollosëse për UÇK-në sikurse ishte trafikimi i organeve.
Kjo qe baza e ngritjes së Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.
Ata që asokohe kishin përgjegjësi shtetërore nuk u treguan në krye të detyrës që të merrte shteti ynë përgjegjësinë bashkë me EULEX-in që t'i hetonte akuzat e ngritura nga D. Marti e që i miratoi Këshilli Evropian.
Shteti ynë, institucionet qeveritare, Kuvendi e Presidenca ishin zhytur më klimën e krijuar me pa të drejtë kundër UÇK-së, sa që nuk e shquan dot se çka realisht po bënin.
Dhe vitet e arrestimit e procesit gjyqësor të katër ish-drejtuesve të UÇK-së nuk u kuptua se ç'rrezik po i kanosej drejtësisë së luftës sonë çlirimtare, qoftë nga besimi se ajo nuk mund të njollosej e qoftë nga motive të tjera.
Tash kjo gjendje, me Rezolutën e Kuvendit për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së dhe me krijimin e Grupit Punues, i përket së kaluarës, sepse Kosova ndodhet në një rrethanë që nuk e priste. U kuptua se edhe një luftë e drejtë çlirimtare sikurse ajo e Kosovës, po nuk u mbrojt vazhdimisht nga shteti, nën ndikimin e shteteve të tjera që nuk e duan lirinë e Kosovës mund t'i ofrojnë drejtësisë të dhëna të manipuluara që e bëjnë dioptrinë e drejtësisë ta shoh jo korrekt dhe të shpreh verdikt që nuk është në përputhje me realitetin dhe të vërtetën.
Duke e parë strukturën gjithëpërfshirëse partiake dhe të personaliteteve të përfshira në Grupin Punues, mund të arrihet në konstatimin se ai është kredibil.
Këtë e përforcojnë edhe deklaratat e z. Konjufca si drejtues, për strategjinë e shtetit në procesin e Apelit.
Kështu, UÇK-ja duket se me procesin e Hagës u bë një mobilizues i kombit, për të na zgjuar, ndërgjegjësuar dhe angazhuar në mënyrë legjitime për të ndihmuar drejtësinë përmes dëshmive për pastërtinë e luftës çlirimtare të popullit shqiptarë, luftë e cila përfundoi me heqjen e vargonjve të robërisë dhe të shtetformimit të Kosovës.
Natyrisht, kjo po bëhet në kontekstin aktual, përmes procesit të Hagës në Apel ndaj katër ish drejtuesve të UÇK-së.
Ajo që mund të thuhet si përfundim është se Kosova u zgjua nga letargjia ku kishte rënë duke e kuptuar se përtej ndonjë rasti individual, përtej atyre rasteve fatkeqe, qëndron interesi i tërë kombit, i shtetit, i lirisë sonë, i secilit dhe i çdo njërit.
U kuptua më qartë se kurrë se të jesh indiferent ndaj vlerave themelore të lirisë sonë që përmblidhen në luftën legjitime të UÇK-së është të lësh lirinë tënde në duart e atyre që nuk e duan lirinë Kosovës.
U kuptua, si asnjëherë, se UÇK-ja, duke qenë vlerë themelore e lirisë dhe e shtetit tonë ju përket të gjithëve e secilit dhe se rreth saj mund të bashkohemi - në një bashkim ku secili jemi të barabartë dhe me dinjitet.
Kështu po përmbushet një objektiv real i UÇK-së: e vërteta e lirisë sonë po bëhet pjesë vlerore e secilit nga ne, ashtu sikurse ishte, sikurse duhej të ishte dhe sikurse është.

KGJK-ja DHE IRZ-ja ORGANIZOJNË PUNËTORI PËR FORCIMIN E MEKANIZMAVE TË VETËQEVERISJES DHE MBIKËQYRJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

PRISHTINË, 29 TETOR - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ), po mban punëtori dyditore me temën "Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmave efektivë për vetëqeverisjen dhe mbikëqyrjen e sistemit të drejtësisë", e cila po zhvillohet në Prishtinë.
Punëtoria ka për qëllim të kontribuojë në forcimin e pavarësisë, integritetit, profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë, përmes shqyrtimit të mekanizmave ekzistues të vetëqeverisjes gjyqësore, mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë institucionale, si dhe identifikimit të praktikave të mira dhe mundësive për përmirësimin e tyre në Kosovë.
Në hapje të saj, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Rrustem Thaçi dhe përfaqësuesi i Ambasadës Gjermane në Kosovë, Payem Ghalendar, iu drejtuan pjesëmarrësve.
Në fjalën e tij kryesuesi Thaçi prezantoi organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, me theks të veçantë në rolin dhe funksionimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ai theksoi rëndësinë e forcimit të pavarësisë gjyqësore dhe të mekanizmave efektivë të vetëqeverisjes dhe mbikëqyrjes si parakusht për një sistem gjyqësor profesional, transparent dhe llogaridhënës.
Gjatë dy ditëve të punëtorisë, përmes prezantimeve dhe diskutimeve profesionale, do të trajtohen tema që ndërlidhen me pavarësinë gjyqësore dhe kërkesat kushtetuese, emërimin, vlerësimin, promovimin dhe zhvillimin profesional të gjyqtarëve, mbikëqyrjen gjyqësore, etikën dhe integritetin profesional, si dhe parandalimin e konflikteve të interesit.
Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet përvojave krahasuese të Gjermanisë dhe Kosovës në fushën e vetëqeverisjes dhe mbikëqyrjes gjyqësore, transparencës dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor ndaj publikut, si dhe zhvillimit të

karrierës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në sistemin gjyqësor.
Në përfundim të punëtorisë, synohet të identifikohen dhe të hartohen rekomandime konkrete për përmirësimin e kornizës ligjore dhe nënligjore, procedurave dhe mekanizmave institucionalë të vetëqeverisjes, mbikëqyrjes dhe llogaridhënies, me qëllim të forcimit të mëtejshëm të funksionimit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë në Kosovë.
Punëtoria udhëhiqet nga ekspertët gjermanë të fushës juridike, prof. dr. Michaela Wittinger, profesoreshë universitare dhe eksperte e lartë juridike si dhe dr. Thomas Dickert, ish-kryetar i Gjykatës së Lartë Rajonale të Nurembergut.
Në të po marrin pjesë anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kryetarë të gjykatave të niveleve të ndryshme, përfshirë Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit, Gjykatën Komerciale, Gjykatën Administrative dhe gjykatat themelore, drejtorë të Sekretariatit të KGjK-së, si dhe staf tjetër i sistemit gjyqësor të Kosovës.

Arrestohen dy persona të dyshuar për krime lufte në rastin e "Masakrës së Padalishtës"

PRISHTINË, 29 TETOR - Policia e Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Luftës, nën autorizimin e Prokurorisë Speciale, ka ndërmarrë veprime hetimore për një periudhë të gjatë kohore në drejtim të dokumentimit të rastit i njohur si "Masakra e Padalishtes" në komunën e Istogut, e ndodhur më 26 mars 1999.
Në koordinim me prokurorin përgjegjës për rastin, hetuesit e Sektorit për Krime Lufte kanë ndërmarrë edhe veprime operative në përputhje me autorizimet përkatëse, duke angazhuar njësi në terren, dhe si rezultat i këtyre veprimeve, të enjten janë lokalizuar dhe arrestuar dy të dyshuar Z. B. dhe G. B. në fshatin Osojan dhe Cerkolez të komunës së Istogut. Të gjitha veprimet e mëtejshme lidhur me rastin do te ndërmerren në bashkërendim me Prokurorinë Speciale.

Kuvendi miraton në lexim të dytë Projektligjin për Byronë

Prishtinë, 29 tetor - Me 66 vota për, Projektligji për Byronë Shtetërore për Procedurën e Verifikimit dhe Konfiskimit të Pasurisë së Pajustifikueshme u miratua të enjten në lexim të dytë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
Ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka thënë se pasuria e pajustifikueshme nuk do të ketë më strehë te pushteti, ndikimi apo emri i askujt. "Ligji duhet dhe do të vlejë për të gjithë, pa përjashtim. Sepse askush, bash askush, nuk qëndron mbi ligjin në republikën tonë", ka thënë Gërvalla.



MIRATOHEN NDRYSHIMET NË BUXHETIN 2026, REFUZOHEN TË GJITHA REKOMANDIMET E OPOZITËS

Prishtinë, 29 tetor - Kuvendi i Kosovës ka miratuar me 62 vota për rishikimin e Buxhetit për vitin 2026, i cili përfshinte shtatë amendamente. Megjithatë, vetëm dy prej tyre morën mbështetjen e deputetëve, ndërsa propozimet e opozitës nuk u miratuan.
Rishikimi i buxhetit u shoqërua me debate dhe akuza mes deputetëve të opozitës dhe ministrit të Financave, Hekuran Murati, lidhur me ndarjen e mjeteve për pagën e 13-të dhe pagesat retroaktive për përvojën e punës.
Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, e cilësoi propozimin e qeverisë si "mbulesë për 120 milionë euro, për të cilat u vendos në fillim të vitit", duke pretenduar se ligji ka probleme si në aspektin procedural, po ashtu edhe në përmbajtje.
Edhe deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, kërkoi sqarime nga Ministria e Financave, duke thënë se duhet të bëhet e qartë nëse ndryshimet

synojnë ta mbulojnë pagën e 13-të, e cila ishte ndarë në fillim të këtij viti.
Ndërkaq deputetja e Aleancës, Teuta Haxhiu, i cilësoi ndryshimet e propozuara si dinakëri të ministrit Murati.
Këto kritika u kundërshtuan nga ministri i Financave, i cili tha se paga e 13-të për vitin 2026 ishte paraparë në buxhet dhe ishte paguar gjatë këtij viti. "Paga e 13-të është e paraparë në buxhet dhe është paguar. Kjo që po ndodh është mbulimi i hendekut nga alokimi i parakohshëm, ashtu siç e ka paraparë Ligji i Buxhetit. E paga e 13-të për vitin e ardhshëm paguhet në fillim të vitit të ardhshëm", deklaroi Murati.
Ai shtoi se ndryshimet lidhen edhe me pagesën retroaktive të përvojës së punës.
Pas kësaj deklarate debati mes ministrit dhe deputetëve opozitarë u ashpërsua. Hoti e akuzoi Muratin për keqpërdorim dhe e quajti gënjeshtar, ndërsa Haxhiu e cilësoi "mashtrues". Bajrami, nga ana tjetër, e quajti situatën "keqplanifikim të planifikuar".
Në shtator qeveria kishte miratuar ndryshimet që parashiheshin të mundësonin rialokimin e 102 milionë eurove për pagën e 13-të për punonjësit e sektorit publik dhe për mbulimin e pagesave retroaktive të diferencës së shtesës prej 0.5-përqindësh për çdo vit përvojë pune në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.
Vitin e kaluar qeveria kishte ndarë pagën e 13-të për punonjësit e sektorit publik.
Shtesa për përvojën e punës ishte ndryshuar me Ligjin për Paga të vitit 2022. Për 15 vjetët e parë të përvojës shtesa ishte ulur nga 0.5 në 0.25 për qind për çdo vit, ndërsa pas vitit të 15-të parashihej 0.5 për qind. Gjykata Kushtetuese e shpalli këtë ndryshim antikushtetues, pas së cilës qytetarët nisën të paraqesin padi për kompensimin retroaktiv të diferencës.
Një tjetër çështje e diskutuar gjatë shqyrtimit të amendamenteve ishte ndarja e një milion eurove për mbulimin e protezave për invalidët e luftës. Megjithatë, propozimi i Komisionit për Mirëqenie Sociale nuk mori mbështetjen e deputetëve.

AVANCIMI I SISTEMIT KORREKTUES TË KOSOVËS, PRIORITET I MINISTRISË SË DREJTËSISË

Prishtinë, 29 tetor - Zëvendësministri i Drejtësisë, Genc Nimoni, mori pjesë në konferencën "Zbatimi i Marrëveshjes Kosovë - Danimarkë për transferimin e të burgosurve në Kosovë: sfidat ligjore, të drejtat e njeriut dhe çështjet operacionale", të organizuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës.
Në fjalën e tij hyrëse, zëvendësministri Nimoni theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet daneze për ngritjen e kapaciteteve profesionale të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përafrimin me standardet ndërkombëtare dhe garantimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria.
Në këtë drejtim, mbi 40 zyrtarë nga Kosova kanë ndjekur dhe janë duke ndjekur trajnime gjashtëmujore në sistemin danez të burgjeve, ndërsa trajnimet po vazhdojnë në Danimarkë dhe Kosovë, me qëllim të përgatitjes së personelit për zbatimin e standardeve dhe praktikave profesionale.
Duke folur për rezultatet e angazhimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, zëvendësministri vuri në pah përfshirjen e tij në rrjetet ndërkombëtare EuroPris dhe ICPA, si dhe vlerësimin me çmimin e ekselencës nga ICPA në tetor të vitit 2025 dhe renditjen ndër pesë vendet e para në konferencën e këtij viti të EuroPris.
Një pjesë e rëndësishme e këtij angazhimi është edhe rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të dënuar.

Aktualisht Shërbimi Korrektues i Kosovës zbaton 10 programe rehabilituese dhe rreth 20 trajnime për aftësim profesional, edukim dhe arsimim, me synim zhvillimin e aftësive dhe përgatitjen e tyre për riintegrim të suksesshëm në shoqëri. Pjesëmarrja në këto programe dhe trajnime ka përfshirë mbi 2 000 të dënuar, duke dëshmuar përparim të theksuar gjatë pesë viteve të fundit.
Sa i përket zbatimit të Marrëveshjes Kosovë - Danimarkë, zëvendësministri Nimoni bëri me dije se po vazhdojnë punimet për renovimin dhe përshtatjen e objektit sipas standardeve daneze si dhe ndërtimin e punëtorive për angazhimin e të burgosurve në punë. Ndërkohë, Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Danez i Burgjeve janë duke punuar në hartimin e procedurave për transportin dhe punësimin e të burgosurve.
Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës mbeten të përkushtuara në avancimin e sistemit korrektues të Kosovës përmes forcimit të kapaciteteve institucionale, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zbatimit të standardeve më të larta profesionale.

Presidentja pret në takim Prattipatin, rikonfirmon forcimin e bashkëpunimit Kosovë - ShBA

Prishtinë, 29 tetor - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula, ka pritur të enjten në takim të ngarkuarën me punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Anu Prattipati, e cila e ka uruar për marrjen e detyrës.
Presidentja Shiroka-Pula ka shprehur mirënjohjen për urimin dhe ka riafirmuar përkushtimin e saj për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe partneritetit strategjik ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
Në këtë kontekst, presidentja Shiroka-Pula ka theksuar rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve dhe të vazhdimit të koordinimit të ngushtë për çështjet me interes të përbashkët, në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë rajonale, si dhe të zhvillimit dhe avancimit të pozitës ndërkombëtare të Kosovës.

‘STRATEGIC GROUP’ DHE ‘OCEAN B HOLDING’ NGA KATARI NISIN INICIATIVËN INVESTUESE PREJ DY MILIARDË DOLLARËSH PËR KOSOVËN DHE SHQIPËRINË

Partneriteti synon investime të mëdha publike dhe private në sektorë strategjikë, me fokus zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe prosperitetin afatgjatë rajonal

Prishtinë, 29 tetor - “Strategic Group” dhe “Ocean B Holding”, me seli në Katar, kanë nënshkruar një kornizë bashkëpunimi strategjik që synon identifikimin, zhvillimin dhe avancimin e mundësive për investime kapitale publike dhe private në Kosovë dhe Shqipëri, me një portofol të synuar investimesh deri në dy miliardë dollarë amerikanë.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, “Ocean B Holding” ka autorizuar zyrtarisht “Strategic Group” që t’i përfaqësojë interesat e saj investuese dhe të avancojë mundësi strategjike në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni Veriore dhe tregje të tjera të Evropës Juglindore.

Mandati i jep “Strategic Group” të drejtën të identifikojë dhe vlerësojë mundësi investimi, të angazhohet me qeveritë dhe aktorët e sektorit privat, të organizojë takime të nivelit të lartë dhe t’i lehtësojë diskutimet dhe negociatat lidhur me investimet potenciale.

Partneriteti do të fokusohet në sektorë me potencial për ndikim të rëndësishëm dhe afatgjatë ekonomik, përfshirë energjinë, naftën dhe gazin, minierat, prodhimin e energjisë elektrike, shëndetësinë dhe zhvillimin e infrastrukturës së madhe.

Ocean B Holding bashkëpunon ndërkombëtarisht me investitorë, institucione financiare, partnerë strategjikë dhe qeveri për të identifikuar, zhvilluar, financuar dhe zbatuar projekte të përmasave të mëdha. “Misioni i ‘Strategic Group’, në thelb, ka të bëjë me njerëzit. Ne duam të sjellim kapital serioz ndërkombëtar, investitorë kredibilë dhe partneritete afatgjata në Kosovë dhe Shqipëri, në mbështetje të qeverive, ekonomive dhe sektorëve privatë të të dyja vendeve”, ka deklaruar Arianit Shehu, pronar i “Strategic Group”, duke shtuar se: “Për ne investimi nuk matet vetëm me madhësinë financiare të një transaksioni. Ai matet me numrin e vendeve të reja të punës që krijohen, familjet që përfitojnë, bizneset që zhvillohen dhe fuqizimin e ekonomive tona. Në të njëjtën kohë, jemi të përkushtuar të mbështesim mundësi për sektorin privat në Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut, sepse prosperiteti më i madh në të gjithë rajonin na fuqizon të gjithëve”.

Shehu ka theksuar se Kosova dhe Shqipëria kanë potencial të jashtëzakonshëm. “Përgjegjësia jonë është të ndihmojmë që ky potencial të shndërrohet në fabrika, projekte energjetike, infrastrukturë, investime në shëndetësi, biznese të reja dhe, mbi të gjitha, vende të qëndrueshme pune. Një portofol investimesh prej 2 miliardë dollarësh mund të ketë ndikim transformues kur kapitali drejtohet në projekte që krijojnë vlerë ekonomike afatgjatë. Ky bashkëpunim përfaqëson një hap tjetër drejt fuqizimit të lidhjeve ndërmjet kapitalit ndërkombëtar dhe Ballkanit Perëndimor, duke vendosur Kosovën dhe Shqipërinë në qendër të një gjenerate të re projektesh strategjike të orientuara drejt rritjes ekonomike, punësimit, zhvillimit të infrastrukturës dhe prosperitetit rajonal”, tha Arianit Shehu.

“Strategic Group” është kompani me seli në Kosovë, e specializuar në zhvillimin e biznesit, lehtësimin e investimeve dhe krijimin e partneriteteve strategjike ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe Lindjes së Mesme.

Ocean B Holding, me seli në Katar, është kompani ndërkombëtare investimesh dhe zhvillimi projektesh në sektorë strategjikë, me një portofol investimesh prej disa miliardë dollarësh në Lindjen e Mesme dhe Afrikë.

Partneriteti synon të sjellë kapital ndërkombëtar dhe investime strategjike në Kosovë, Shqipëri dhe rajon.

PAKETA E FINANCIMIT E MBËSHTETUR NGA BE-ja DO TË OFROJË MBËSHTETJE PËR AMVISËRITË, NVM-të DHE BIZNESET E UDHËHEQURA NGA GRATË

Paketa e financimit deri në 21 milionë euro do të ofrojë përkrahje për amvisëri, NVM dhe biznese të udhëhequra nga gratë. Financimi do ta promovojë efiçiencën e energjisë, energjinë e ripërtërishme, digjitalizimin dhe automatizimin. Paketa do të ofrojë përkrahje shtesë përmes granteve të BE-së dhe asistencës teknike

Prishtinë, 29 tetor - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) ka siguruar një paketë financimi deri në 21 milionë euro për TEB Bankën Kosovë për zgjerim të qasjes në financim të gjelbër, digjital dhe gjithëpërfshirës në Kosovë.

Ky financim do t’u mundësojë amvisërive dhe bizneseve të investojnë për zgjidhje me efiçiencë të energjisë dhe energji të ripërtërishme, ndërkohë që do t’u ndihmojë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) të adoptojnë teknologji të gjelbra, t’i digjitalizojnë operacionet dhe të fusin në përdorim procese të automatizuara. Gjithashtu, do ta rrisë qasjen në financa dhe njohuri për bizneset e udhëhequra nga gratë.

Ky financimi i ri përbëhet nga katër linja krediti që targetojnë nevoja të ndryshme investuese: 6 milionë euro përmes Instrumentit për Financim të Ekonomisë së Gjelbër (GEFF), për t’u mundësuar amvisërive të investojnë për rritjen e efiçiencës së energjisë në shtëpitë e tyre, si dhe për të mbështetur investimet për efiçiencë të energjisë dhe energji të ripërtërishme në sektorin publik. Ky financim do të ndihmojë në rritjen e adoptimit të teknologjive të gjelbra dhe uljen e përdorimit të energjisë; 5 milionë euro përmes programit për NVM të gjelbra (SME Go Green), për t’u ndihmuar ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) të investojnë për efiçiencë të energjisë dhe të resurseve, energji të ripërtërishme dhe teknologji të tjera të gjelbra, në mënyrë që operacionet e tyre të bëhen më të qëndrueshme dhe konkurruese. Të paktën 33 për qind e këtyre investimeve pritet të jenë në zinxhirin e vlerës së agrobiznesit, ndërsa 25 për qind e NMVM-ve të mbështetura pritet të jenë të udhëhequra nga gratë; 5 milionë euro përmes programit për Kalim në Digjital (Go Digital) në Ballkanin Perëndimor, për t’u mundësuar NVM-ve investime për automatizim, digjitalizim dhe teknologji të gjelbra, si dhe për t’u ndihmuar t’i modernizojnë operacionet e tyre, të përmirësojnë konkurrueshmërinë dhe të adoptojnë standardet e BE-së. Të paktën 60 për qind e këtyre investimeve do të financojnë projekte për automatizim dhe digjitalizim, dhe të paktën 60 për qind do të mbështesin ekonominë e gjelbër; 5 milionë euro përmes programit për Gratë në Biznes në Ballkanin Perëndimor, për të zgjeruar qasjen në financa dhe njohuri për NMVM-të e udhëhequra nga gratë. Ky financim do t’u ndihmojë grave ndërmarrëse të investojnë në bizneset e tyre, të forcojnë konkurrueshmërinë dhe të shfrytëzojnë mundësi të reja për rritje.

Bashkimi Evropian (BE) po e plotëson paketën e financimit me grante dhe asistencë teknike për investime të gjelbra dhe digjitale përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF). BE-ja do të mbështesë edhe financimin e Grave në Biznes përmes Fondit Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus (EFSD+), duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve dhe mbulimin e riskut të humbjes së parë. Nga Fondi i Bashkëpunimit Japoni-BERZh do të ofrohet asistencë teknike shtesë në kuadër të Instrumentit për Financim të Ekonomisë së Gjelbër.

Sergiy Maslichenko, udhëheqës i BERZh-it për Kosovën, u shpreh se: “Qasja në financa është kritike për bizneset që duan të investojnë, të modernizohen dhe të rriten. Duke punuar me partnerin tonë të kahershëm TEB Banka, ne do t’u ndihmojmë NVM-ve në Kosovë të bëhen më të gjelbra dhe më konkurruese, ndërkohë që zgjerojmë mundësitë për gratë ndërmarrëse dhe u ndihmojmë amvisërive të përmirësojnë efiçiencën e energjisë të shtëpive të tyre dhe të ulin kostot e energjisë.”

Cihan Yilmaz, drejtor menaxhues i TEB Banka, u shpreh se: “Në TEB Banka Kosovë, jemi të përkushtuar ndaj mbështetjes së rritjes së qëndrueshme dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë së Kosovës. Kjo paketë e re financimi me BERZh-in përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të ndihmuar në uljen e kostove të energjisë, për t’u mundësuar bizneseve të investojnë në transformim të gjelbër dhe digjital, si dhe për ta forcuar më tej mbështetjen për gratë ndërmarrëse. Ne besojmë se investimet në qëndrueshmëri, digjitalizim dhe gjithëpërfshirje janë esenciale për zhvillimin ekonomik afatgjatë dhe reziliencën. Si partner i kahershëm i BERZh-it, jemi krenarë që vazhdojmë të kontribuojmë në tranzicionin e Kosovës drejt një ekonomie më të gjelbër, më digjitale dhe më gjithëpërfshirëse, duke krijuar mundësi të reja për rritje dhe sukses për klientët tanë në të gjithë sektorët”,

Hubert Perr, udhëheqës për bashkëpunimin në Zyrën e BE-së në Kosovë, u shpreh se: “Bashkimi Evropian është krenar që po e mbështet këtë paketë financimi, e cila do t’u ndihmojë amvisërive dhe bizneseve të investojnë për një të ardhme më të gjelbër dhe më digjitale. Përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe Fondit Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus, ne po i kombinojmë huatë e BERZh-it me grante të BE-së, asistencë teknike dhe ndarje risku për t’i zgjeruar mundësitë, për të forcuar konkurrueshmërinë dhe për të përmirësuar qasjen në financa, edhe për bizneset e udhëhequra nga gratë”.

E themeluar në vitin 2007, TEB Banka Kosovë është degë e TEB Holding, një ndërmarrje e përbashkët mes BNP Paribas dhe Grupit Çolakoğlu. Ajo ofron shërbime financiare për individë dhe biznese, me fokus në kreditimin për shitje me pakicë dhe NVM.

BERZh-i është investitor institucional kryesues në Kosovë, duke investuar pothuajse 990 milionë euro përmes 152 projekteve në vend. Shumica e këtyre investimeve janë realizuar në sektorin privat.

XHEVAT ZEKAJ I PANËNSHTRUAR PARA PUSHTUESIT, I PATHYER PARA VUAJTJEVE, BESNIK NDAJ KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

Ismet SYLEJMANI

Më 22 tetor 2026, pas përfundimit të ekspozitës në nderim të Heronjve të Kombit, Fehmi Lladrovci dhe Xhevë Krasniqi-Lladrovci mbajtur në Reporting House, ishte organizuar një koktej për pjesëmarrësit e ekspozitës!

Na njoftuan se kokteji do të mbahej në një vend me një emër të veçantë, me një emër që në vetvete përmbante një histori të tërë sakrificash, vuajtjesh, qëndrese dhe përpjekjesh për liri, ai vend ishte Burgu i Idealit!

Në qendër të Prishtinës ndodhet ndërtesa e ish-Burgut Qendror, një ndërtesë që dikur ishte vend i izolimit, i torturave çnjerëzore, i rdahjeve shtazarake, i vuajtjeve dhe i dënimeve të atdhetarëve shqiptarë, ndërsa sot është shndërruar në Burg-Muze dhe mban emrin domethënës, Burgu i Idealit!

Lufta heroike dhe titanike e UÇK-së, gjaku i derdhur i Heronjëve dhe Dëshmorëve të Kombit, bënë të mundur çlirimin e Kosovës nga SHBA e NATO, dhe solli realitetin e ri, ky është ndryshim i madh historik!

Dikur aty burgoseshin njerëzit që kërkonin lirinë dhe çlirimin e Kosovës, ndërsa sot njerëzit e lirë hyjnë për të nderuar kujtimin në nderim të tyre!

Dikur dyert e atij burgu mbylleshin mbi trupat e atdhetarëve shqiptarë, ndërsa sot ato hapen për të dëshmuar se ideali për të cilin ata u burgosën, u torturuan dhe u sakrifikuan, nuk mundi të burgosej kurrë!

Mirëpo, për mua, ajo që do të përjetoja brenda atyre mureve nuk do të ishte një vizitë e zakonshme!

Ishte një përballje e rëndë shpirtërore me historinë e gjallë të vuajtjeve, me kujtimet e Udhëheqësve, shokëve e bashkëveprimtarëve, me sakrificat e një brezi që kishte marrë mbi supet e veta barrën e luftës për lirinë dhe çlirimin e Kosovës nga Jugosllavia dhe Serbia pushtuese!

Kur arritëm te Burgu i Idealit, pjesëmarrja ishte jashtëzakonisht e madhe!

Hapësira ishte e ngushtë, një koridor i gjatë ishte mbushur me njerëz, radha për t'u shërbyer me ushqim ishte e gjatë, ndërsa bisedat zhvilloheshin në këmbë, në një atmosferë që dukej festive, por që për mua kishte një kuptim krejt tjetër!

Në një vend tjetër, një koktej i tillë do të ishte një ngjarje e zakonshme shoqërore!

Por jo aty!

Jo në ato korridore!

Jo brenda atyre mureve ku dikur ishin dëgjuar urdhra policësh, udbashësh, ku kishin kaluar të burgosur politikë shqiptarë, ku ishin përjetuar izolimi, torturat, uria, ankthi dhe pritja e gjatë e lirisë!

Morëm nga një pjatë dhe u shërbyem me pak ushqim!

Dhe pikërisht aty filloi një nga përjetimet më të rënda shpirtërore të jetës sime!

Për herë të parë në jetën time, kisha ushqim përpara, por nuk mund të haja!

Nuk ishte mungesë oreksi!

Nuk ishte as lodhje!

Ishte diçka shumë më e thellë, shumë më e rëndë dhe shumë më tronditëse!

Herë pas here e shikoja Shokun tim Xhevatin!

E dija se ndodhesha në një burg ku kishin vuajtur atdhetarë dhe patriotë shqiptarë, ku njerëz të përkushtuar ndaj lirisë dhe çlirimit te Atdheut, kishin kaluar ditë e net të tëra pa bukë, ku grevat e urisë ishin shndërruar në një formë të qëndresës kundër padrejtësisë dhe shtypjes!

Unë mbaja një pjatë me ushqim në duar, ndërsa mendja më shkonte te ata që dikur kishin qëndruar aty me stomakun bosh, me trupin e rraskapitur, të dërmuar e gjakatosur, por me bindjen e pathyer se Kosova duhej të bëhej e lirë!

Sa e rëndë është të hash bukë në vendin ku të tjerëve, bashkëmendimtarëve e bashkëveprimtarëve, dikur u është mohuar ajo!

Sa e dhimbshme është ta kesh lirinë tënde përpara dhe të kujtosh ata që për atë liri kishin dhënë rininë, shëndetin dhe vitet më të bukura të jetës së tyre!

Por, në të njëjtën kohë, brenda meje lindi edhe një ndjenjë tjetër!

Dëshiroja të haja ushqimin!

Po, dëshiroja të merrja disa kafshata, sepse e dija se kjo ditë nuk kishte ardhur vetvetiu, por ishte berë rrugë e gjatë lufte e përpjekjeje!

Që ai burg të shndërrohej nga një institucion i represionit në një muze të kujtesës kombëtare, ishte dashur një veprimtari e gjatë atdhetare, politike, patriotike dhe revolucionare!

Ishin dashur dekada organizimi, ilegaliteti, përndjekjeje, burgosjesh, sakrificash dhe qëndrese heroike të heronjëve të gjallë, të mëdhenjë e më pak të mëdhenj!

Ishte dashur të zhvillohej luftë!

Ishte dashur të derdhej gjak!

Ishte dashur që bijtë dhe bijat më të vendosur të popullit shqiptar të merrnin mbi vete përgjegjësinë e rëndë historike të luftës për çlirimin me armë në dorë të Kosovës!

Dhe unë, si pjesë e atij kontingjenti të madh atdhetarësh e veprimtarësh, e ndieja se ato pak kafshata nuk ishin thjesht ushqim i rëndomtë!

Ato ishin edhe dëshmi e një kohe tjetër!

E një kohe kur ne mund të hynim dhe të dilnim të lirë nga një ndërtesë, nga e cila dikur Udhëheqësit, Shokët dhe bashkëveprimtarët tanë nuk mund të dilnin sipas vullnetit të tyre!

Prandaj mora disa kafshata!

Por buka mezi më kalonte në fyt, sepse zemra më qante dhe mundohesha të rrija i qetë përpara Xhevatit!

Brenda meje përplaseshin dy botë, gëzimi për lirinë e fituar dhe dhimbja për çmimin e tmerrshëm që ishte paguar për të!

Ndihesha sikur shpirti po më çahej nga kujtimet dhe sikur, në çdo çast, do të shpërtheja në vaj nga një dhimbje që nuk mund ta shpjegoja me fjalë!

Por me vonë doli se kulmi i këtij përjetimi ende nuk kishte ardhur!

Kulmi erdhi kur, së bashku me Shokun Xhevat Zekaj, filluam të lëviznim nëpër hapësirat e ish-burgut, ku Ai vetë dhe shumë shokë e bashkëveprimtarë të tjerë kishin vuajtur dënimet dhe izolimin!

Atëherë aty gjithçka ndryshoi!

Nuk po ecja më vetëm nëpër një ndërtesë historike!

Po ecja përkrah një njeriu që kishte qenë vetë i burgosur brenda atyre mureve!

Për mua, Shoku Xhevat Zekaj nuk ishte një vizitor i zakonshëm!

Ai ishte dëshmitar i gjallë i atij burgu, një njeri që kishte provuar mbi trupin dhe shpirtin e vet peshën e represionit jugosllav, serb e tradhëtar kundër veprimtarisë së Tij atdhetare çlirimtare shqiptare!

Filluam t'i vizitonim dhomat njëra pas tjetrës!

Kaluam korridoret, dolëm në shëtitore, u ngjitëm në pjesën e sipërme, prej nga policët dikur i vëzhgonin të burgosurit gjatë shëtitjes së tyre, dhe pastaj u kthyem përsëri te dhomat!

Mendoja për ato ecje të shkurtra që për të burgosurit kishin qenë një nga mundësitë e pakta për të dalë nga izolimi i qelive!

Mendoja për dallimin e madh ndërmjet nesh sot dhe atyre atëhere!

Ne po lëviznim të lirë, ndaleshim ku dëshironim, bisedonim dhe ktheheshim sipas vullnetit tonë!

Ata dikur nuk kishin pasur as lirinë të vendosnin sa gjatë do të qëndronin në ajër të hapur!

Sa e shtrenjtë është bërë liria, çlirimi dhe Pavarësia e Kosovës, kur e sheh vendin ku ajo u ishte mohuar njerëzve që kishin luftuar për të!

Gjatë vizitës sa ishim aty, takuam edhe Naim Balidemajn, djalin e atdhetarit të madh Rexhep Balidemaj!

Naimi kishte qëndruar disa çaste në dhomën numër 5, në të cilën babai i tij, atdhetari Rexhep Balidemaj, kishte kaluar nëntë muaj burgimi!

Nëntë muaj!

Nëntë muaj nga jeta e një njeriu, të kaluar brenda një dhome burgu!

Por çfarë kuptimi mund të kenë nëntë muaj për një djalë që sot hyn në atë dhomë dhe e di se aty dikurë ka vuajtur blBabai i tij?!

Çfarë mund të ndiejë një djalë kur qëndron në vendin ku Babait të tij i ishte në atë dhimë vuajtje?!

Për mua, takimi me Naimin në atë vend kishte një domethënie të jashtëzakonshme njerëzore dhe kombëtare!

Aty takoheshin dy kohë!

Koha e baballarëve që kishin vuajtur për lirinë dhe koha e bijve që sot mund të hyjnë të lirë në vendet ku prindërit e tyre ishin mbajtur të burgosur!

Pastaj i tregova Naimit se edhe

→

Shoku Xhevat Zekaj, kishte qenë i burgosur ketu në këtë burg!
Dhe pikërisht në dhomën numër 2, ku kishte qëndruar plot tre muaj!
Tre muaj në vetmi!
Tre muaj izolim, ku njeriu përballet jo vetëm me muret që e rrethojnë, por edhe me peshën e rëndë të heshtjes, me dashurinë ndaj çështjes kombëtare, më shqetësimin për shokët e organizuar që veprojnë jashtë mureve të qelive e të burgjeve, me mallin për familjen, me pasigurinë për të nesërmen dhe me përpjekjen dhe qendresën për ta mbajtur të pathyer vullnetin e vet!
Xhevati sigurisht se nuk e shikonte atë dhomë si ne!
Unë po e shikoja për herë të parë si muze!
Ai me siguri se po e rikthente në kujtesë të Tij si një pjesë të jetës së Tij dikur dhe si Burg Muze te Idealit!
Dhe pikërisht aty u shfaq një hollësi që, për mendimin tim, ka rëndësi të jashtëzakonshme për ruajtjen e së vërtetës historike!
Xhevati ishte i pakënaqur me disa ndryshime që i ishin bërë pamjes së brendshme të ambientit!
Ai shpjegonte se në kohën kur kishte qenë i burgosur, në dhomë nuk kishte pasur banjë!
Në vend të saj, kishte qenë një enë e ngjashme me kovë, e cila shërbente për kryerjen e nevojave fiziologjike!
Çdo mëngjes, të burgosurit duhej ta merrnin atë enë, ta zbraznin në tualetin e zakonshëm dhe ta pastronin!
E dëgjoja Xhevatin dhe ndieja se çdo fjalë e tij kishte një peshë të rëndë!
Sepse kjo nuk ishte një hollësi e parëndësishme e jetës së burgut nga të burgosurit!
Ishte pjesë e realitetit të përditshëm të të burgosurve politikë shqiptarë!
Ishte një nga ato forma të poshtërimit njerëzor që nuk mund të kuptohen plotësisht nëse nuk njihen kushtet e vërteta në të cilat ata kishin jetuar!
Dhe këtu lind një përgjegjësi e madhe!
Kur një burg shndërrohet në muze, nuk mjafton vetëm t'i ruhet ndërtesa!
Atij burgu duhet t'i ruhet edhe e vërteta reale!
Nëse një dhomë burgu ndryshohet aq shumë sa ish-i burgosuri nuk e njeh më realitetin në të cilin ka vuajtur, atëherë kemi rrezikuar të humbim një pjesë të dëshmisë së saktë historike!
Muzeu nuk duhet ta zbukurojë burgun!
Duhet ta dëshmojë atë!
Duhet të tregojë jo vetëm kush ishte burgosur, por edhe si kishte jetuar, si ishte trajtuar, çfarë kishte përballuar, sikur dihet se përse kishte qëndruar i pathyer!
Memoria kombëtare nuk ndërtohet duke i fshehur vuajtjet, por duke ua treguar brezave me vërtetësi dhe me saktësi!
Nga tetë vjet burg që Xhevat Zekaj kishte vuajtur për veprimtarinë e tij atdhetare, politike, patriotike e revolucionare për lirinë dhe çlirimin e Kosovës nga pushtimi jugosllavo-serb, tre muaj i kishte kaluar në dhomën numër 2 të Burgut Qendror të Prishtinës, në vetmi!
Tetë vjet burg!
Tetë vjet nga jeta e një njeriu!
Tetë vjet larg jetës së lirë, larg familjes, larg shokëve, larg mundësive që i takojnë çdo njeriu!
Por ato vite ishin bërë pjesë e çmimit të rëndë që brezi historik i tij pagoi për idealin kombëtar, për Kosovën e lirë e të pavarur nga Serbia pushtuese!
Duke ecur më tej nëpër labirinthet e ish-burgut famkeq, arritëm edhe te vendi ku ishin zhvilluar vizitat e familjarëve!
Aty Xhevati ma tregoi pozicionin ku qëndronte ai gjatë vizitave dhe anën tjetër ku qëndronin familjarët e tij!

Ishte një tjetër çast thellësisht tronditës!
Mendova se sa e rëndë duhet të ketë qenë për një të burgosur ta shihte pjestarin e familjes së Tij dhe të mos mund të largohej së bashku me të!
Sa i rëndë duhet të ketë qenë përfundimi i një vizite, kur i burgosuri duhej të kthehej përsëri në qeli, ndërsa familjarët të largoheshin duke e lënë pas njeriun e tyre të dashur, te torturuar barbarisht e në gjendje të rëndë!
Sa Nëna shqiptare do të kenë pritur kthimin e bijve të tyre?!
Sa Nëna e Baballarë, bashkëshorte, fëmijë, vëllezër e motra, nipër e mbesa i kanë numëruar ditët, muajt dhe vitet e burgjeve të njerëzve të tyre të daahur?!
Sigurisht se shume prej atyre të burgosurve heronjësh do ta kenë fshehur dhimbjen përpara familjarëve, vetëm e vetëm që të mos ua shtonin vuajtjet atyre?!
Nuk kam qenë dëshmitar i atyre takimeve, por duke qëndruar aty, pranë Xhevatit, ishte e pamundur të mos mendoja për gjithë atë histori të dramës njerëzore që kishte kaluar nëpër atë vend, Shok hero i gjallë i vuajtjeve dhe torturave çnjerëzore!
Përmasat e luftës për liri e çlirim të Atdheut nga zgjedha pushtuese serbe, nuk maten vetëm me betejat e ndryshme të zhvilluara ghatë luftës së armatosur çlirimtare të UÇK-së dhe me gjakun e derdhur në front!
Ato maten edhe me vitet e burgut, me izolimin, me netët e gjata të ankthit, me torturat, me qëndresën përballë dhunës dhe me familjet që bartën mbi supe pasojat e veprimtarisë atdhetare!
Lufta për lirinë dhe çlirimin e Kosovës nuk filloi vetëm kur u dëgjuan krismat e armëve të lirisë!
Ajo kishte rrënjë të thella në ndërgjegjen e popullit, në organizimet ilegale, në qëndresën politike, në burgjet e ish-Jugosllavisë, në demonstratat, në përndjekjet dhe në sakrificat e brezave të tërë liridashës!
Shumë prej atyre bijëve e bijave që kishin kaluar nëpër burgje, më vonë u bënë pjesë e luftës së armatosur dhe përpjekjeve të mëdha që çuan në çlirimin e Kosovës!
Prandaj, nuk mund të kuptohet plotësisht historia e lirisë dhe çlirimit tonë pa u njohur historia e ish – të burgosurve politikë shqiptarë!
Në fund, së bashku me Shokun Xhevat Zekaj, e me miq të tjerë, dolëm nga ndërtesa e Burgut të Idealit!
Dolëm nga dera e burgut si njerëz të lirë!
Por unë nuk dola shpirtërisht ashtu siç kisha hyrë!
Dola me një dhimbje të madhe në shpirt, me zemrën e rënduar dhe me një tronditje të thellë emocionale, të cilën nuk e kisha përjetuar në ato përmasa asnjëherë më parë në jetën time!
Nuk më hiqej nga mendja pjata me ushqim që kisha mbajtur në dorë!
Nuk më hiqej nga mendja dhoma numër 2, ku Shoku Xhevat Zekaj kishte kaluar tre muaj në vetmi!
Nuk më hiqej nga mendja vendi i vizitave familjare!
Dhe, mbi të gjitha, nuk më hiqej nga mendja fakti se për mua ato ishin disa orë vizite, ndërsa për Ushëheqësit, Shokët, e për bashkëveprimtarët e mi kishin qenë muaj dhe vite të tëra jete!
Sa i madh ky dallim!
Unë dola kur desha!
Ata kishin dalë vetëm kur ua kishin lejuar të tjerët, pasi kishin vuajtur dënimet apo pas vendimeve të autoriteteve pushtuese e tradhëtare që i kishin burgosur!
Kjo ishte e vërteta që më goditi më rëndë se gjithçka tjetër!
Në jetën time kisha vizituar edhe Burgun-Muze të Gjirokastrës.
Ai kishte qenë burgu i parë muze që kisha vizituar!
Por ky i Prishtinës ishte i dyti dhe, për mua, kishte një peshë të veçantë shpirtërore!
Sepse në këtë burg kishin vuajtur shokët tanë!
Kishin vuajtur udhëheqësit tanë!
Kishin vuajtur bashkëveprimtarët tanë!
Kishin vuajtur atdhetarë, patriotë dhe revolucionarë të shquar shqiptarë të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi!
Ishte një rikthim shpirtëror në rrugën e gjatë dhe të mundimshme të lirisë së Kosovës!
Dhe dua ta përfundoj këtë shkrim me një ndjenjë që nuk më është larguar që nga ajo ditë!
Kur hyra në atë burg, e dija se po hyja në një vend historik!
Kur dola nga aty, e kuptova dhe e ndjeva edhe më thellë, se sa shumë jetë njerëzore, sa shumë dhimbje dhe sa shumë sakrifica të panumërta qëndrojnë pas fjalës LIRI, ÇLIRIM E PAVARËSI të KOSOVËS nga Serbia pushtuese!
Atë ditë, në atë burg, mora disa kafshata bukë, por nuk munda t'i shijoja!
Sepse përpara syve të mi nuk ishte vetëm buka!
Ishin Udhëheqësit, Shokët e Bashkëveprimtarët e mi që kishin vuajtur, që ishin torturuar, që ishin rrahur shtazarakisht!
Ishin udhëheqësit tanë që kishin mbajtur mbi supe barrën e rëndë të idealit kombëtar!
Ishin atdhetarët e patriotët që kishin dalë nga rinia e tyre drejt burgjeve, me shpresën se një ditë brezat që do të vinin pas tyre do të jetonin të lirë, kështu sikur edhe jemi tash!
Sot, dyert e atij burgu janë të hapura!
Kosova është e lirë!
Shokët tanë që mbijetuan mund të kthehen në vendin ku dikur ishin të burgosur, të ecin nëpër korridoret e tij dhe të dalin prej tij si njerëz të lirë, fitimtarë e triumfatorë!
Por vitet që ua mori burgu nuk ua kthen dot askush!
Rininë dhe vitet që e kanë kaluar në burgje e qeli nuk ua kthen askush!
Vuajtjet e përjetuara nuk mund t'ua fshijë askush nga memoria!
Ngushëllimi i vetëm për heronjtë e burgjeve dhe qelive shqiptare, është largimi Serbisë pushtuese dhe aparatit të saj policoro-ushtarak nga Kosova!

Prishtinë, 28 Tetor 2026!



sport

Përballje interesante në xhiron e 12-të në Superligën e Kosovës

PRISHTINË, 29 TETOR - Superliga e Kosovës në futboll do të vazhdojë këtë javë me ndeshjet e xhiros së 12-të. Sikurse në xhirot e mëparshme, edhe ndeshjet e kësaj jave do të zhvillohen përgjatë tri ditëve, sot (e premte), nesër (e shtunë) dhe pasnesër (e diel), ka njoftuar Federata e Futbollit e Kosovës (FFK).

Një ndeshje do të zhvillohet sot, dy nesër dhe dy të tjera pasnesër, kur edhe do të përmbyllet kjo xhiro. Xhiroja do të hapet sot (e premte) me duelin Ballkani - Drenica, i cili do të zhvillohet në Suharekë, nga ora 13:00. Nesër (e shtunë) do të zhvillohen dy përballjet e radhës: Llapi - Prishtina dhe Drita - Vushtrria. Ndeshja në Podujevë do të nisë në orën 13:00, ndërsa dueli në Gjilan do të fillojë në orën 18:00. Ndërsa pasnesër (e diel) ndeshja e parë do të jetë ajo ndërmjet Malishevës dhe Feronikelit '74, e cila do të nisë në orën 13:00. Xhiroja e 12-të do të mbyllet me përballjen Dukagjini - Gjilani, që do të zhvillohet në Klinë dhe do të nisë në orën 17:00.

LIGA U13 DHE U15, BAZË E RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN E FUTBOLLIT TË VAJZAVE NË KOSOVË

PRISHTINË, 29 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në kuadër të strategjisë për zhvillimin e futbollit të vajzave dhe grave, po vazhdon të investojë në krijimin e mundësive për përfshirjen e vajzave në futboll që nga moshat e hershme. Liga U13 dhe U15, e mbështetur nga UEFA, po luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e lojtareve të reja, rritjen e numrit të klubeve dhe krijimin e një baze të qëndrueshme për të ardhmen e futbollit të vajzave në vend.

Edicioni i tretë i kësaj lige po u ofron vajzave më shumë mundësi për të mësuar elementët bazë të futbollit, për të fituar përvojë garuese dhe për t'u përgatitur për kalimin në grupmoshat më të mëdha dhe ekipet seniore.

Anëtarja e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së dhe kryetarja e Komisionit për Futbollin e Vajzave dhe Grave, Vjollca Krasniqi, ka vlerësuar se projekti po jep rezultate pozitive, ndërsa këtë vit është shënuar edhe rritje e numrit të klubeve pjesëmarrëse. "Edicioni i tretë është duke u zhvilluar këtë vit dhe mendojmë që kemi bërë një punë të mirë lidhur me këtë kategori të vajzave, sepse kjo kategori nesër-pasnesër do të jetë pjesë bazike e klubeve të moshave më të rritura", ka thënë Krasniqi.

Ajo ka theksuar rëndësinë e mbështetjes së UEFA-s, duke shprehur shpresën që liga të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, me synimin që garat për grupmoshat U13 dhe U15 të organizohen si liga të ndara. Krasniqi ka veçuar edhe angazhimin e vajzave që kanë luajtur futboll në të kaluarën dhe që tashmë po kontribuojnë në zhvillimin e këtij sporti në role të ndryshme, si delegate, gjyqtare dhe trajnere. Ndërsa trajneri i KFV Prishtina, Altin Imeri, ka vlerësuar se liga ua ka lehtësuar klubeve përgatitjen e vajzave për kalimin nga grupmoshat e reja në ekipet U17 dhe ato seniore. Sipas tij, më herët shumë vajza kalonin drejtpërdrejt në U17 ose në ekipet seniore, pa pasur mundësi të mjaftueshme për t'i mësuar elementët bazë të lojës dhe për t'u zhvilluar gradualisht.

"Për shembull, te klubi ynë Prishtina ne i kemi dy grupe me nga 25 vajza aktive në këtë ligë. Kësisoj kemi hapësirë t'u japim mundësi të gjitha vajzave ta mësojnë lojën e futbollit dhe të kënaqen", ka thënë Imeri, duke falënderuar FFK-në për mbështetjen.

Për lojtaret e reja liga përfaqëson më shumë se një garë sportive. Ajo u ofron mundësi për t'i zhvilluar aftësitë, për të fituar përvojë dhe për të ndërtuar synime për të ardhmen.

Kurse Sara Lekaj, e cila luan futboll prej shtatë vjetësh, e ka cilësuar shumë të mirë përvojën e saj te KFV Prishtina, duke theksuar se futbolli është sporti që e pëlqen që nga fëmijëria.

Në anën tjetër, Vlera Neziri nga KFF Vizioni, e cila luan futboll që nga mosha shtatëvjeçare dhe është pjesë e Kombëtares U15 të Kosovës, ka thënë se synon ta vazhdojë zhvillimin e saj dhe që në të ardhmen të arrijë te Kombëtarja A.

Rëndësia e ligës vërehet edhe te përfshirja e vajzave nga zonat rurale. Trajneri i KFF Barileva, Durim Berisha, ka bërë me dije se këtë vit klubi i tij ka marrë pjesë për herë të parë në garat e FFK-së me grupmoshat U13 dhe U15. Ai ka treguar se klubi ka rreth 30 vajza të grupmoshave të ndryshme, ndërsa për pjesëmarrjen në gara janë përzgjedhur lojtaret e grupmoshave U13 dhe U15. Sipas tij, vajzat vijnë nga zona të ndryshme, nga Tënezhdolli deri në Bardhosh.

Për rëndësinë e kësaj mundësie ka folur edhe Robert Lekaj, prind i futbollistes Sara Lekaj. Ai ka vlerësuar se pjesëmarrja në ligë u mundëson vajzave të përballen me bashkëmoshataret e tyre dhe të kuptojnë më mirë nivelin e zhvillimit të tyre.

Përmes Ligës U13 dhe U15, FFK-ja synon ta zgjerojë bazën e futbollit të vajzave, të krijojë kushte më të mira për zhvillimin e talenteve të reja dhe të ndërtojë një rrugë më të qëndrueshme drejt ekipeve të grupmoshave më të mëdha dhe Kombëtares së Kosovës.

'FRANCE FOOTBALL' E SHPALL CRISTIANO RONALDON E VITIT 2008 MË TË MIRIN NË HISTORINË E 'TOPIT TË ARTË'

PARIS, 29 TETOR - Revista franceze "France Football" ka paraqitur një çmim të ri, të quajtur B.O.A.T. (Më i Miri i Topave të Artë të të Gjitha Kohëve), i krijuar për ta përcaktuar edicionin më të mirë të këtij trofeu në histori. Fitues është shpallur Cristiano Ronaldo me edicionin e vitit 2008.

Ky ishte "Topi i parë i Artë" në karrierën e portugezit, i cili në votim ka lënë pas edicionin e vitit 2012 të Lionel Messit. Dy yjet e futbollit botëror kryesojnë listën e 12 edicioneve më të votuara, ndërsa pas tyre renditet Ronaldo Nazario me "Topin e Artë" të vitit 2002. Për këtë çmim të veçantë, "France Football" ka ndryshuar mënyrën tradicionale të votimit. Në vend të gazetarëve, kanë qenë përdoruesit e revistës ata që kanë votuar për edicionin më të mirë të "Topit të Artë" në histori. Në garë janë përfshirë të gjithë futbollistët që e kanë fituar këtë çmim të paktën dy herë gjatë karrierës së tyre.

Trepça fiton bindshëm, Bashkimi pëson humbje në FIBA Europe Cup

TBILISI/PRIZREN, 29 TETOR - Trepça ka shënuar fitoren e tretë radhazi në FIBA Europe Cup, ndërsa Bashkimi ka pësuar humbje në shtëpi nga skuadra franceze Elan Chalon. Kampionia e Kosovës, Trepça, ka triumfuar ndaj Batumit të Gjeorgjisë me rezultat 91:70, në ndeshjen e vlefshme për xhiron e katërt të Grupit A, të zhvilluar në Tbilisi. Skuadra nga Mitrovica ka vazhduar kështu serinë e fitoreve, pasi paraprakisht kishte mposhtur Splitin në Kroaci dhe Opavën çeke në Mitrovicë. Në ndeshjen e parë të grupit, "xehetarët" kishin pësuar humbje në palestrën "Minatori" nga Patrasi grek. Me këtë fitore Trepça i ka rritur gjasat për të avancuar në fazën tjetër të garës. Në ndeshjen e radhës, pas një jave, mitrovicasit do të përballen me Trierin në Gjermani. Në anën tjetër, Bashkimi ka pësuar humbje të thellë në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren, ku është mposhtur nga skuadra franceze Elan Chalon me rezultat 94:66 në kuadër të Grupit F. Pas tri ndeshjeve të zhvilluara në FIBA Europe Cup, Bashkimi ka regjistruar një fitore dhe dy humbje. Në xhiron e ardhshme, pas një jave, skuadra prizrenase do të luajë në udhëtim ndaj Biotekno Korfez Basket të Turqisë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin "Ferma për rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve, ngastrat kadastrale: P-71813037-00183-0; P-71813037-00184-0 dhe P-71813084-00190-0, zona kadastrale: Korishë dhe Shpenadi, Komuna Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.12.2026 në ora 11:00 ne objektin e ri te Komunës se Prizrenit, ne hapësirat e Administratës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Ferma për rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve, ngastrat kadastrale: P-71813037-00183-0; P-71813037-00184-0 dhe P-71813084-00190-0, zona kadastrale: Korishë dhe Shpenadi, Komuna Prizren.

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin
vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Gerti Foods" sh.p.k, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e brumërave, ne Parcelat P-71813046-00299-1 dhe P-71813046-00300-4, në Zonën Kadastrale Lubizhdë, Komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.12.2026 në ora 13:30 ne objektin e ri te Komunës se Prizrenit, ne hapësirat e Administratës, ne hapësirat e Administratës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për fabrikën për prodhimin e brumërave, ne Parcelat P-71813046-00299-1 dhe P-71813046-00300-4, në Zonën Kadastrale Lubizhdë, Komuna e Prizrenit.

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin
vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "AAE TEX" L.L.C. me pronar Blerim Isufi, me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811573999 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "AAE TEX" L.L.C. sa sjedištem u Gnjilane, s vlasnikom Blerim Isufi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811573999 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "AAE TEX" L.L.C. with the owner Blerim Isufi, with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811573999 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES

100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË

ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L